



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 387 Prot.


Tiranë, më 04.04 2016

VENDIM Nr. 17, datë 30.03.2016

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "**Për Trashëgiminë Kulturore**" (i ndryshuar), Neni 47, VKM Nr.725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë"(i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.3, të datës 30.03.2016, pasi shqyrtoi *Raportin arkeologjik mbi gjetjet rastësore për projektin "Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimeve të ujërave të zeza të qytetit Sarandë"* paraqitur nga subjekti i licencuar në arkeologji "K.A.E.XH" sh.p.k. dhe relacionin e verifikimit në terren në kuadër të mbikëqyrjes arkeologjike realizuar nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik,

VENDOSI:

1. Të miratojë *Raportin arkeologjik mbi gjetjet rastësore për projektin "Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimeve të ujërave të zeza të qytetit Sarandë"* paraqitur nga subjekti i licencuar në arkeologji "K.A.E.XH" sh.p.k. dhe relacionin e verifikimit në terren në kuadër të mbikëqyrjes arkeologjike realizuar nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik.
2. Të kryhet nga subjekti i licencuar në arkeologji, gërmimi arkeologjik i shpëtimit i banesës të periudhës romake, zbuluar si rezultat i punimeve për rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimeve të qytetit Sarandë, sipas konceptit të gërmimit, pjesë e raportit të mësipërm, në një sipërfaqe prej 12 m².
3. Subjekti "Ujësjellës - Kanalizime Sarandë" sh.a duhet të lidhë prapakisht kontratë trepalëshe me subjektin e licencuar në arkeologji, i cili do të kryejë gërmimin arkeologjik të shpëtimit të banesës së periudhës romake dhe ASHA, që do të realizojë mbikëqyrjen e tyre. Raporti i gërmimit arkeologjik të shpëtimit do të paraqitet në KKA e radhës.
4. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10 2015 dhe përcaktimeve përkatëse të kontratës tre palëshe.
5. Të realizohet dokumentimi i plotë dhe rilevimi i gërmimit arkeologjik të shpëtimit, si dhe i të gjitha gjetjeve arkeologjike që mund të dalin gjatë zbatimit të projektit



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E KULTURËS

"Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimeve të ujërave të zeza të qytetit Sarandë", në funksion të pasurimit të hartës arkeologjike të qytetit të Sarandës.

6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
7. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI
MINISTËR



SEKRETARI I KKA
RUDINA ZOTO

